

Passage4prevent

MODEL I REFERUAR
PËR PARANDALIMIN
E RADIKALIZMIT

DR. MARIJA RISTESKA

Passage4prevent

**MODEL I REFERUAR PËR
PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT**

DR. MARIJA RISTESKA

Ky model i politikave u zhvillua në kuadër të projektit: **“Edukimi për Pandalim - Fuqizimi i Punonjësve Arsimorë dhe Prindërve për Ndërtimin e Rezistencës tek të Rinjtë ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm”** të implementuar nga Qendra për Hulumtim dhe Hartim të Politikave - CRPM dhe Qendra për Zhvillimin e Arsimit - CED në bashkëpunim me NEXUS - konceptin civil. Publikimi është përgatitur me mbështetjen e misionit të OSBE-së në Shkup dhe Hedayah - Qendër për Përsosmëri në Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm si pjesë e *Programit Global STRIVE, përmes Instrumentit Kontribues për Stabilitetin dhe Paqen (IcSP) të Bashkimit Evropian*.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk përfaqësojnë mendimet e OSBE-së, Bashkimit Evropian apo ndonjë organizate tjetër mbështetëse.

Contents

Hyrje.....	5
1. Parandalimi nga ekstremizmi i dhunshëm	6
2. Mbrotja nga radikalizmi - qasje e shëndetit publik	7
3. Harta dhe kapaciteti i institucioneve	9
3.1. Komiteti Nacional për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Kundër Terrorizmit (LKEDH and LKT).....	10
3.2. Komuna	11
3.3. Policia	13
3.4. Qendra për Punë Sociale	14
3.5. Shkollat	15
3.6. Qendrat shëndetësore	16
3.7. Komunitetet fetare.....	17
4. Modeli i referimit	18
4.1 Struktura e modelit të referimit, roli dhe kompetencat	22
4.2. Procesi i referimit.....	28
Faza 1: Iniciimi.....	28
Faza 2: Vlerësimi.....	30
Faza 3: Mbështetja.....	32
5. Financimi i modelit parandalues.....	35
6. Rritja e ndërgjegjësimit dhe trajnimi	36
7. Menaxhimi i rrezikut.....	39
8. Operacionalizimi i modelit - gjetjet nga punëtoritë e zhvillimit të politikave.....	40
8.1. Gostivar	41
8.2. Tetovë	42
8.3. Kumanovë	43
8.4. Shkupi.....	45
Aneksi 1: Marrëveshje për ndarjen e informacionit.....	47
Aneksi 2: Modeli i Gostivarit	49
Regjistri i Shërbimeve të Gostivarit.....	49
Aneksi 3: Modeli i Tetovës	52
Regjistri i Shërbimeve të Tetovës.....	52
Regjistri i Shërbimeve të Kumanovës.....	54
Aneksi 5: Modeli i Shkupit	55
Regjistri i Shërbimeve të Shkupit	55

Hyrje

Ky model i referimit është duke u zhvilluar në kuadër të projektit “Edukimi për Parandalim - Fuqizimi i Punonjësve Arsimorë dhe Prindërve për të Ndërtuar Qendrueshmërinë e Rinisë ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm”, zbatuar nga CRPM në partneritet me CED dhe NEXUS, financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit Strive që menaxhohet nga Hedeyah – Qendra për Përsosmëri për Parandalim nga Ekstremizmi i Dhunshëm. Projekti E2P synon të zhvillojë qendrueshmërinë e komunitetit ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet fuqizimit të punonjësve arsimorë dhe prindërve të nxënësve. Modeli bazohet në Hartimin dhe Vlerësimin e Kapaciteteve të institucioneve të nivelit lokal të zhvilluar nga IOM në fund të vitit 2018 si dhe raportin nga tryezat e rrumbullakëta me aktorët komunalë mbi zbatimin e strategjisë nacionale për LKEDH, që u drejtua nga Misioni i OSBE-së në Shkup. Modeli i referimit për parandalimin nga radikalizmi është i koordinuar me iniciativat e vazhdueshme të Search for Common Ground dhe CIVIL - Qendrës për Liri të cilat financohen nga Ambasada e Britanisë dhe Amerikane.

Modeli i referimit Passage4Prevent është ngulitur në kuadrin ligjor dhe institucional të vendit. Ai gjithashtu bazohet në përvojat e vendeve të tjera të cilat kanë zhvilluar dhe zbatuar sisteme të referimit si pjesë e modeleve të tyre para-kriminale dhe parandaluese ndaj radikalizmit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm. Modeli është vullnetar për nga natyra dhe mbështetet në vlerësime jo-diskriminuese të rrezikut që duhet të zbatohen nga profesionistë të trajnuar: aktorë jo-të sigurisë, duke përfshirë ofruesit e kujdesit psiko-social, mësuesit, punëtorët shëndetësorë, udhëheqësit fetarë dhe të tjerë të komunitetit në marrjen e masave proaktive parandaluese për të mbrojtur individin, komunitetin dhe shoqërinë, duke ofruar shërbime mbështetëse dhe trajtim që zvogëlojnë rreziqet ndaj radikalizmit, adresojnë nevojat për rizhvendosjen e vëmendjes ndaj shërbimeve që mund të ndryshojnë sjelljen e individëve përmes një plani mbështetës të përshtatur në mënyrë specifike për ata që janë referuar. Modeli i referimit përmban bashkëpunim të më shumë agjencive për të cilin duhet të azhurohen kanalet ekzistuese të koordinimit dhe protokollet për ndarjen e informacionit për fenomenet e tjera, si delikuenca e të miturve, dhuna në familje etj.

1. Parandalimi nga ekstremizmi i dhunshëm

Në nivel shtetëror dhe lokal, marrëdhëniet ndëretnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut midis komuniteteve vazhdojnë të mbeten të tensionuara sidomos në ato pjesë të vendit, ku grupet ekstremiste janë akoma të pranishme dhe aktive, të cilat janë të gatshme të përdorin dhunën për arritjen e qëllimeve të tyre politike. Prandaj, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka miratuar në fillim të vitit 2018 një Strategji për të luftuar forma të radikalizmit që mund të çojnë në ekstremizëm të dhunshëm. Strategjia ofron qasje të reja gjithëpërfshirëse dhe holistike, të bazuara në parimet parandaluese të cilat bazohen në Parimet Udhëzuese në vijim për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm - LKEDH: parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë; parimet e sundimit të ligjit, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, mosdiskriminimi dhe përqendrimi në mbrojtjen e të dhënave personale; parimi i sigurimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të sigurt dhe sovranë; parimi qasjes nacionale gjithëpërfshirëse.

Qëllimi i Strategjisë Nacionale është të sigurojë dhe promovojë një shtet të sigurt dhe prosperues, nëpërmjet aktiviteteve të koordinuara, që parandalojnë, mbrojnë, ndjekin dhe reagojnë ndaj identifikimit të hershëm dhe zbulimit të faktorëve që kontribuojnë në radikalizëm, ekstremizëm dhe veprim të dhunshëm në formën e terrorizmit dhe/ose aktiviteteve terroriste. Strategjia në nivel kombëtar synon të përmirësojë standardizimin e reagimit të saj institucional ndaj LKEDH përmes krijimit të një trajnimi gjithëpërfshirës dhe përkrahje për informacionet mes agjencive, të dhënat dhe platformat për shkëmbimin e inteligjencës, si dhe për të përmirësuar besimin e ndërsjellë dhe bashkëpunimin midis shërbimeve qeveritare të sigurisë dhe udhëheqësve të komunitetit. Strategjia në nivel komunal ka për qëllim zhvillimin e proceseve dhe procedurave për të inkurajuar programet e komunitetit për të mbështetur kohezionin shoqëror që parandalon ekstremizmin e dhunshëm.

Strategjia e mbështet Qasjen Gjithëpërfshirëse të Qeverisë (QGJQ) dhe Qasjen Gjithëpërfshirëse të Shoqërisë (QGJSH) e cila në thelb nënkupton përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe shoqërisë në përgjithësi në parandalimin e shenjave të radikalizimit. Për këtë qëllim krijimi i Ekipeve Funkzionale, Grupet Punuese, Task Forcat dhe bashkëpunimi ndër-institucional është thelbësor për ruajtjen dhe promovimin e mirëqenies së

fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve nga radikalizimi që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm.

Strategjia Kombëtare në Qëllimin Strategjik 1.3 Bashkësia e Fortë dhe e Qëndrueshme parashikon një aktivitet që është bazë për këtë dokument. Aktiviteti 1.3.8 rregullon Ngritjen e një Mekanizmi Parandalues Nacional për referimin e personave në periudhën 2018-2019. Ky mekanizëm është planifikuar të përfshijë Komitetin Nacional për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Kundër Terrorizmit, Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale, Komisionin Shtetëror për Marrëdhëniet me Komunitetet dhe Grupet Fetare dhe Ministrinë e Shëndetësisë në fazën e zhvillimit dhe pilotimit të mekanizmit parandalues nacional. Nuk ka asnjë akt tjetër që siguron bazën ligjore për themelimin e një mekanizmi parandalues nacional për referimin e personave.

Themelimi i një mekanizmi parandalues për referimin e individëve është pjesë e një sërë intervenimesh të mundshme që plotësojnë përpjekjet për të parandaluar radikalizmin që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm. Qëllimi kryesor i parandalimit është ndërtimi i qendrueshmërisë së komunitetit dhe kohezionit social për t'i rezistuar apelit të radikalizmit. Ai përqendrohet në komunitetet e paradikalizuara duke rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut dhe qeverisjen; korrupsionin; adresimin e rreziqeve të ekstremizmit të dhunshëm përmes edukimit; fushatat e informimit publik dhe debatet e komunitetit dhe trajnimi për shkathtësi të tilla si dialogjet; mendim kritik; shkrim-leximin e mediave; zgjidhjen e konflikteve ndëretnike dhe ndërfetare. Hapi i dytë në parandalim merr qasje gjithëpërfshirëse të komunitetit duke angazhuar grupe të ndryshme të komunitetit për të hartuar planet për mbështetjen e ndërhyrjes për komunitetet potencialisht të radikalizuara nëpërmjet referimit ndaj shërbimeve që ofrojnë mbështetje psiko-sociale, mentorim, udhëzime fetare mbi dallimet dhe doktrinat teologjike, ofrojnë trajnime dhe shkathtësi që do të përmirësojnë punësimin, do të ofrojnë trajnime dhe shërbime që do të mbështesin individët për t'i rezistuar shtytjes dhe tërheqjes së faktorëve drejt radikalizimit.

2. Mbrojtja nga radikalizmi - qasje e shëndetit publik

Strategjia Nacionale për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

udhëhiqet nga këto parime bazë të LKEDH: qytetarë të sigurtë të Republikës së Maqedonisë së Veriut; ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse që do të mbështesin dhe zhvillojnë besimin e publikut në to; sigurimi i një ambienti që është i favorshëm për zhvillimin më të shpejtë ekonomik; arritja e unitetit kombëtar dhe komunitete të qëndrueshme ndaj radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.


Strategjia vendos mekanizmin parandalues për referimin e individëve në nivel lokal, pasi që njësitë e vetëqeverisjes lokale janë organet më të afërta qeveritare për qytetarët dhe mund të ofrojnë mbështetjen dhe shërbimet e duhura për parandalimin e radikalizmit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm. Baza për komunën për të vendosur modelin e referimit për parandalimin e radikalizmit është në Nenin 21 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale i cili rregullon kompetencat komunale, “komunat në mënyrë të pavarur dhe në bazë të ligjit mund të rregullojnë fushëveprimin e tyre të punës në interes të publikut dhe me rëndësi për komunitetin lokal”. Në këtë drejtim, komunat kanë një numër kompetencash që rregullohen në Nenin 22 dhe gjithashtu mund të konsiderohen si bazë ligjore për mekanizmin parandalues. Për shembull, komuna është përgjegjëse për mbrojtjen sociale dhe mirëqenien e fëmijëve dhe në veçanti duhet të mbrojë individët që janë të ekspozuar ndaj rrezikut social dhe të kryejë ngritjen e vetëdijes publike. Për më tepër, paragrafi 9 i të njëjtit nen rregullon kompetencat në mbrojtjen shëndetësore kur aktivitetet parandaluese dhe sigurimi i mbështetjes për njerëzit me nevoja specifike mund të konsiderohen gjithashtu si bazë ligjore për krijimin e modelit parandalues. Të marra së bashku, këto kompetenca mbështesin zbatimin e një lente të shëndetit publik për zhvillimin e një mekanizmi referimi.

Qasja e shëndetit publik njih rëndësinë e të kuptuarit të radikalizmit që mund të çojë në ekstremizmin e dhunshëm si një fenomen social. Duke pasur parasysh se ky fenomen mund të ketë një ndikim shumë të gjërë në një shoqëri, edhe përtej dëmit fizik të shkaktuar nga një sulm i vetëm dhe si rrjedhim nevojën për të përfshirë një gamë të aktorëve jo-të sigurisë, përfshirë ofruesit e kujdesit psiko-social, mësuesit dhe udhëheqësit fetarë dhe të tjerë të komunitetit janë të rëndësishëm në marrjen e masave pro-aktive parandaluese për të mbrojtur individin, komunitetin dhe shoqërinë përkatëse¹.

1 OSCE 2019, “*Të Kuptuarit e Mekanizmave Referues për Parandalimin dhe Luftën*”

Programet parandaluese që korniza ligjore në vend lejon që të themelohen nga komunat duhet të synojnë grupet “në rrezik” dhe të kërkojnë të ndërhyjnë në rrugën e individit kah radikalizmi terrorist përpara se të kalohet vija e veprimit kriminal. Këto quhen programe “off-ramps” ose “ekzit programe”. Ato zakonisht janë vullnetare dhe përfshijnë mbështetje psiko-sociale, mentorim, debat teologjik/doktrinor, trajnim dhe mbështetje për arsim dhe/ose punësim.

Figura 1²



3. Harta dhe kapaciteti i institucioneve

Harta e institucioneve dhe vlerësimi i kapaciteteve të tyre për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm janë zhvilluar nga profesorët Suzana Bornarova dhe Natasha Bogoevska në emër të Organizatës Ndërkombëtare për Migracion³ (IOM). Gjetjet janë paraqitur në një Raport mbi hartimin e kapaciteteve institucionale për parandalimin e ekstremizmit

Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Çon në Terrorizëm: Drejtimi i sfidave dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut - Një fokus në Evropën Juglindore

- Challgren, Jonathan et al. Lufta Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm: Zbatimi i Modelit të Shëndetit Publik, 1st ed. Georgetown University, Center for Security Studies, National Security Critical Issues Task Force, 2016, cituar në OSCE 2019 “**Të Kuptuarit e Mekanizmave Referues për Parandalimin dhe Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Çon në Terrorizëm: Drejtimi i sfidave dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut - Një fokus në Evropën Juglindore**”

<http://georgetownsecuritystudiesreview.org/wp-content/uploads/2016/10/NSCITF-Report-on-Countering-Violent-Extremism.pdf>

- Bornarova Suzana and Bogoevska Natasha (2018), *Raport mbi hartimin e kapaciteteve institucionale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm*, IOM

të dhunshëm. Përveç kësaj, janë përdorur edhe dy burime të tjera: studiimi bazë i kryer nga CRPM lidhur me “Perceptimet e punëtorëve arsimor në shkolla dhe zyrtarëve të komunitetit nga Shkupi, Kumanova, Tetova dhe Gostivari për radikalizmin që çon në ekstremizëm të dhunshëm” dhe raportet nga diskutimet komunale të organizuara nga OSBE për zbatimin e strategjisë nacionale të LKEDH në nivel lokal. Të gjitha burimet janë prodhuar gjatë vitit 2018 duke përdorur metoda kërkimore pjesëmarrëse. Bazuar në këto të dhëna, institucionet që duhet të përfshihen në modelin parandalues për referimin e individëve janë përshkruar në seksionet pasuese.

3.1. Komiteti Nacional për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Kundër Terrorizmit (LKEDH and LKT)

Komiteti Nacional për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (LKEDH) dhe Kundër Terrorizmit (LKT) është themeluar me një vendim në vitin 2017 si një organ koordinues kombëtar për të monitoruar dhe analizuar situatën në lidhje me LKEDH dhe LKT, dhe të koordinojë aktivitetet e institucioneve relevante që punojnë në adresimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm dhe akteve të terrorizmit. Komiteti Nacional udhëhiqet dhe përfaqësohet nga Koordinatori Nacional për LKEDH dhe LKT. Përbërja e Komitetit Nacional është bërë nga të gjitha institucionet⁴ relevante, të cilat kontribuojnë nga aspekte të ndryshme në parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe në luftën kundër terrorizmit, duke krijuar kështu bazën për bashkëpunimin multi-sektorial në nivel strategjik. Komiteti harton strategjitë kombëtare për LKEDH dhe LKT, me planet përkatëse të veprimit; koordinon dhe drejton aktivitetet e të gjitha subjekteve të përfshira në zbatimin e planeve që rrjedhin nga strategjitë nacionale në këtë fushë; ndërton marrëdhënie me përfaqësuesit e shoqërisë civile, vetëqeverisjes lokale, komuniteteve fetare, ekspertëve dhe komunitetit akademik me qëllim të përcaktimit dhe zbatimit të masave të përshtatshme për LKEDH dhe

4 Ministria e Brendshme; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Drejtësisë; Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve; Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Vetëqeverisjes Lokale; Ministria e Punës dhe Politikës Sociale; Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës; Ministria e Transportit dhe Lidhjeve; Drejtoria për Inteligjencë Financiare; Drejtoria për Policinë Financiare; Administrata Doganore; Agjencia e Inteligjencës; Prokuroria Publike Themelore për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit; Qendra për Menaxhimin e Krizave; Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim; Agjencia për Komunikime Elektronike; Agjencia për Rininë dhe Sportet dhe Komisioni për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Fetare

LKT; monitoron tendencat rajonale dhe globale dhe komunikon me institucionet dhe partnerët përkatës në nivel rajonal dhe ndërkombëtar; koordinon procesin e kryerjes së vlerësimeve, analizave dhe hulumtimeve mbi shkaqet dhe format e reja, por gjithashtu trendet e reja në rekrutimin e terroristëve; dhe koordinon aktivitetet në lidhje me zbatimin e fushatave nacionale për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që mund të çojë në terrorizëm, organizimin e debateve inkluzive gjithëpërfshirëse, forumeve, seminareve e të ngjashme⁵.

Raportet e hartimit vlerësojnë se “statusi aktual i Koordinatorit Nacional dhe zëvendës koordinatorëve nuk ofron mundësi për një veprim të organizuar institucional”. Jo të gjithë anëtarët e Komitetit kanë kapacitete për monitorimin, analizë dhe koordinimin e aktiviteteve që synojnë parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Prandaj, raporti i hartimit i IOM rekomandon trajnime të specializuara në veçanti për përfaqësuesit e institucioneve që nuk konsiderohen tradicionalisht si pjesë e fushës së sigurisë; si dhe trajnime të përqendruara në komponentën e parandalimit social, e cila, megjithëse është kompetencë e shumë institucioneve të përfshira në punën e Komitetit Nacional, nuk është njohur dhe promovuar mjaftueshëm.⁶

3.2. Komuna

Komunat janë njësitë e vetëqeverisjes subnacionale. Lista e kompetencave për të cilat ngarkohen komunat për të kryer punë me interes publik rregullohen me Nenin 22 të Ligjit për vetëqeverisje lokale: planifikimi urban (urban dhe rural), mbrojtja e mjedisit dhe natyrës, zhvillimi ekonomik lokal, aktivitetet komunale, kultura, sporti dhe rekreacioni, mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve, edukimi - themelimi, financimi dhe menaxhimi i shkollave deri në nivelin e mesëm në bashkëpunim me qeverinë qendrore, mbrojtjen primare shëndetësore, masat për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve, mbrojtja nga zjaerri, mbikëqyrja e kryerjes së kompetencave dhe detyrave të tjera të përcaktuara me ligj.⁷ Komunat qeverisen nga një kryetar komune dhe një këshill komunal. Ndër kompetencat e Këshillit janë miratimi i statutit komunal, nxjerrja e vendimeve dhe akteve të tjera, përcaktimi i planifikimit hapësinor, themelor

5 Vendim mbi Themelimin e Komitetit Nacional për LKEDH dhe LKT (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 98/2017)

6

7

dhe të detajizuar urban, miratimi i buxhetit dhe llogarive përfundimtare për zbatimin e buxhetit, mbikëqyrja e punës së ndërmarrjeve publike, ofruesit e shërbimeve dhe organet e tjera të themeluara dhe/ose të menaxhuara nga komuna.

Duhet të theksohet se puna e hartimit të politikave për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm sapo ka filluar të shfaqet në vend, që shpjegon nivelin e ulët të njohurive dhe ndërgjegjësimit të Strategjisë Nacionale për LKEDH dhe mungesën aktuale të një sistemi reagimi ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Që nga miratimi i Strategjisë Nacionale për LKEDH nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në shkurt të vitit 2018, komunat gjithashtu janë përgjegjëse për kontributin e tyre në sistemin e reagimit institucional ndaj këtij fenomeni. Autoritetet komunale duhet të përgatisin plane veprimi lokale dhe së bashku me ekipet lokale të veprimit duhet të kontribuojnë në zbatimin e Strategjisë Nacionale për LKEDH.

Në çdo qasje të bazuar në komunitet për parandalimin e radikalizimit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm, komuna është një institucion qendror ku është ankoruar modeli i parandalimit. Megjithatë, dy raporte hulumtuese tregojnë se “komunat kanë nevojë për ngritjen e vetëdijes, në mënyrë që secili në komunat e tyre të kuptojë në mënyrë të barabartë rreziqet që lidhen me lejimin e shfaqjes së ekstremizmit brenda shoqërive të tyre, duke nxitur kështu një linjë tjetër të qendrueshmërisë kundër këtij fenomeni”.⁸

Hulumtimi i CRPM tregon se komunat kanë pak dijeni për rolin e tyre në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Për më tepër, as Strategjia, as komunat siç vërehet nga hulumtimi nuk kanë treguar nevojë për të mbledhur të dhëna në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm. Për më tepër, kapacitetet e komunave duhet të përmirësohen në mënyrë që ata të kenë një rol aktiv në sistemin e reagimit për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, por edhe për të ndjekur dhe raportuar numrin, karakterin dhe nivelin e incidenteve të dhunshme dhe të retorikës ekstremiste të përdorur nga palë të ndryshme të interesit në komunitet. Ngritja e një sistemi për grumbullimin e të dhënave dhe menaxhimin e të dhënave në nivel lokal, si dhe raportimi i rregullt dhe analiza e tendencave në nivel nacional është një nevojë kritike.⁹

8 Filip Stojkovski & Natasia Kalajdziovski (2018), Community Perspectives on the Prevention of Violent Extremism in Macedonia, Democracy Lab and Bergof Foundation

9 Filip Stojkovski, Ivan Stefanoski, Kristijan Aleksovski (2019), *Studimi bazë: Perceptimet*

3.3. Policia

Siguria publike dhe nationale ofrohet nga Ministria për Punë të Brendshme (MPB) dhe nga forcat policore.¹⁰ Plani Strategjik i Ministrisë për Punë të Brendshme 2018-2020¹¹, përfshin aktivitete reformuese që do të lejojnë pjesëmarrjen në luftën kundër kërcënimeve dhe sfidave moderne të sigurisë, duke përfshirë terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Puna e policisë kryhet nga Byroja për Siguri Publike nëpërmjet sektorëve të punëve të brendshme që janë themeluar në vend varësisht nga madhësia e zonës gjeografike, numrit të popullsisë, numrit të veprave penale dhe kundërvajtjeve. Në këtë aspekt, sektori për punë të brendshme sipas ligjit ka këto përgjegjësi për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm: monitoron dhe analizon gjendjen e sigurisë dhe fenomenet që rrezikojnë sigurinë publike; dhe punon në parandalimin e kriminalitetit. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës në sektorin e punëve të brendshme, si dhe në stacionet dhe njësitë e policisë, siguron bazën për kryerjen e aktiviteteve parandaluese në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm nga punonjësit e policisë në nivel lokal.¹² Në çdo stacion të policisë ku është themeluar sektori për punë të brendshme, ekzistojnë tre inspektorë për parandalim: për rendin dhe qetësinë publike, trafikun dhe çështjet penale¹³. Megjithatë, kapaciteti për parandalim u ndërtua në mënyrë specifike përmes zbatimit të projektit “Puna Policore në Komunitet në Funksion të Parandalimit të Radikalizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm” me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup.¹⁴ Për këtë qëllim dhe sipas Rregullores për Zbatimin e Punës Policore, puna policore në komunitet, aktiviteti i policisë së rregullt, asaj që kryen aktivitete patrulluese dhe moto-patrulluese janë të rëndësishë së

e punonjësve front-line të shkollave dhe zyrtarëve të komunitetit nga Shkupi, Kumanova, Tetova dhe Gostivari mbi radikalizmin që çon në ekstremizëm të dhunshëm, CRPM

10 Ligji mbi Punë të Brendshme (Gazeta Zyrtare Nr. 42/2014, 116/2014, 33/2015), online: <http://www.mvr.gov.mk/Upload/Documents/ZVR%20nov%20precisten%2005.03.15.pdf>

11 Plani Strategjik i Ministrisë për Punë të Brendshme 2018-2020, online: [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/%D0%A1%D0%9F-2018-2020-%D0%B7%D0%B0-%D1%81%D0%B0%D1%98%D1%82\(1\).pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/%D0%A1%D0%9F-2018-2020-%D0%B7%D0%B0-%D1%81%D0%B0%D1%98%D1%82(1).pdf)

12 Bornarova Suzana and Bogoevska Natasha (2018), *Raport mbi hartimin e kapaciteteve institucionale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm*, IOM

13 Ibid

14 Sipas *Raportit të IOM-it në hartimin e kapaciteteve institucionale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm*, u trajnuan një numër i konsiderueshëm i punonjësve të policisë dhe punonjësve në Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim (1,400 policë dhe 500 persona në fushën e kriminalistikës).

madhe. Këto aktivitete nuk kanë marrë rol të caktuar në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në komunitetin lokal, përveç në Kumanovë, ku gjatë vitit 2018 Ministria e Brendshme ka filluar zbatimin e projektit për futjen e policit të lagjes ose oficerit të policisë në Kumanovë.¹⁵

3.4. Qendra për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale (QPS) funksionon si institucion publik për mbrojtje sociale, me autorizim publik për kryerjen e aktiviteteve të mbrojtjes sociale sipas Ligjit për Mbrojtjen Sociale. Sipas Ligjit për Mbrojtjen Sociale, QPS-të duhet të zbatojnë masat dhe aktivitetet për parandalimin social, d.m.th. të parandalojnë shfaqjen e rreziqeve sociale, zbulimin e hershëm dhe trajtimin e hershëm të individit të ekspozuar ndaj rrezikut social, me qëllim që të kapërcehen ose zbuten pasojat e dëmshme nga ekspozimi ndaj rrezikut social. Në fushën e parandalimit social, masat janë ndërmarrë për të parandaluar paraqitjen e rrezikut social për individët, familjen ose grupin e individëve, nëpërmjet punës edukative dhe këshilldhënëse, zhvillimin e formave të vetë-ndihmës, vullnetarizmit me angazhim personal dhe përdorimin e metodave të tjera që korrespondojnë me nevojat e përfituesve të mbrojtjes sociale.¹⁶

Sigurimi i shërbimeve sociale, duke i përfshirë aktivitetet parandaluese nga Qendrat për Punë Sociale, mbështetet në bashkëpunimin e shumë agjencive me komunën, institucionet parashkollore, shkollat, institucionet shëndetësore dhe organet e tjera shtetërore dhe autoritetet, personat juridikë, individë dhe shoqatat. QPS-ët i planifikojnë aktivitetet parandaluese në programet vjetore të punës; megjithatë, raporti i hartimit i IOM-it vlerëson se megjithëse programet vjetore të QPS parashikojnë aktivitete parandaluese, asnjë burim financiar nuk është alokuar për këto aktivitete dhe për këtë arsye asnjë aktivitet PEDH nuk është zbatuar deri më tani.

15 Bornarova Suzana and Bogoevska Natasha (2018), *Raport mbi hartimin e kapaciteteve institucionale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm*, IOM

16 Ligji për Mbrojtjen Sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 72/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15 dhe 30/16, 163/2017)

3.5. Shkollat

Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm duke angazhuar punonjësit e shkollave (mësuesit, drejtorët dhe zyrtarët administrativë) është një aspekt veçanërisht i rëndësishëm për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm tek të rinjtë, ku arsimimi ose mungesa e tij mund të jetë një komponent kritik nëse dikush do të zhvillojë pikëpamje ekstremiste gjatë jetës së tyre. Në këtë drejtim ekzistojnë masa që përdoren aktualisht si në vijim: masat pedagogjike në shkollat¹⁷ fillore dhe masat pedagogjike të aplikuara për shkëlqen e detyrave dhe mos përmbushjen e detyrimeve si student¹⁸.

Për më tepër, një *masë referimi këshillimi* përdoret nëse: gjatë vitit shkollor nxënësi ka një notë negative në tre ose më shumë lëndë, nxënësi ka bërë më shumë se dhjetë mungesa të pa-arsyeshme ose 100 të arsyeshme, nxënësi nuk ka dënim, nxënësi e fyen mësuesin, nxënësi merr pjesë në përleshje apo forma të tjera të dhunës, nxënësi tregon një sjellje asociale ose antisociale, nxënësi sillet imoralisht ose është joetik dhe arritjet e nxënësit kanë rënë dukshëm në një periudhë të shkurtër kohore. Këshillimi bëhet në përputhje me Programin për Këshillimin e Prindërve, i cili përgatitet nga Shërbimi Pedagogjik.¹⁹

Megjithatë, të gjitha masat e përdorura dhe të zhvilluara rishtazi duhet të informohen për konceptin e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe të dizajnohen për të ulur cenueshmërinë ndaj radikalizmit. Për këtë qëllim, Studimi Bazë i CRPM lidhur me perceptimet bazë tregon se: (1) punonjësit e shkollave nuk kanë qartësi në lidhje me dallimin në mes të termave kryesore në orbitën e LKEDH ose në lidhje me atë që se çka është ekstremizmi i dhunshëm; (2) gjithashtu u mungon njohuria për shumicën e strategjive nacionale mbi këtë temë. Studimi identifikoi nevojat e mësuesve për të përfshirë temat mbi rreziqet e ekstremizmit të dhunshëm në planprogramin shkollor, trajnimin²⁰, dhe burimet dhe

17 Paragjykimi, paralajmërimi verbal, paralajmërimi me shkrim, ulja e vlerësimit të sjelljes, lëvizja e nxënësit në një klasë tjetër dhe largimi i nxënësit në një shkollë tjetër fillore, nëse ka pëlqim nga kjo shkollë për të pranuar nxënësin

18 Paralajmërim me shkrim, paralajmërim para largimit dhe largimit nga shkolla publike. Masa pedagogjike e largimit mund të shqiptohet vetëm për shkelje më të rënda të detyrës së përcaktuar me statutin e shkollës

19 Bornarova Suzana and Bogoevska Natasha (2018), *Raport mbi hartimin e kapaciteteve institucionale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm*, IOM

20 Sipas studimit, një pjesë e madhe e mësuesve nuk kishin ndjekur trajnime mbi temën e

mjetet për aktivitetet parandaluese në shkolla. Në përgjithësi rekomandohet një qasje sistematike dhe e standardizuar e LKEDH në shkolla. Nevojitet edhe një reformë e shërbimeve të këshillimit pasi është shumë e formalizuar, jofleksibile dhe nuk përshtatet me nevojat dhe specifikat e gjendjes së përditshme të secilit nxënës dhe familjes së tij/saj.²¹

3.6. Qendrat shëndetësore

Në një sistem me shumë agjenci për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, sfera e kujdesit shëndetësor është një lidhje e rëndësishme pasi përfshin një sistem të masave, aktiviteteve dhe procedurave sociale dhe individuale për: ruajtjen dhe promovimin e shëndetit, parandalimin, zbulimin e hershëm dhe shtypjen e sëmundjeve, dhe trajtimi efektiv, kujdesi shëndetësor dhe rehabilitimi dhe masa të tjera të rregulluara me Ligjin për Mbrojtjen Sociale dhe Ligjin për Shëndetin Mendor.²² Derisa nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë shkakore mes sëmundjes mendore dhe ekstremizmit të dhunshëm, ka shumë prova që dëshmojnë se në shumë raste të rinjtë që radikalizohen deri në dhunë përjetojnë një përshtatje të dobët psikologjike.²³ Prandaj, trajtimi i këtyre fenomeneve në të shumtën e rasteve përfshin profesionistë të shëndetit mendor dhe institucionet me kapacitetet e tyre aktuale të përmirësuara dhe të përshtatura ndaj ndjeshmërisë kulturore që rrethon trajtimin e shëndetit mendor ose kujdesit tjetër psiko-social në secilin vend.

Institucionet psikiatrike dhe qendrat për shëndetin mendor ofrojnë trajtim për personat me probleme të shëndetit mendor të çdo lloji, promovimin e shëndetit mendor dhe parandalimin e sëmundjeve mendore dhe kujdesin psikosocial, duke përfshirë rehabilitimin e komunitetit. Ekzistojnë tre qendra të shëndetit mendor në territorin e Qytetit të Shkupit dhe një qendër shëndeti mendor në Tetovë, Strumicë, Gjevgjeli, Demir

EDH ose tolerancës etnike/fetare në pesë vitet e fundit (78%).

21 Studimi i hartave të IOM-it përcakton se në thelb, legjislacioni mbi këshillimin është shumë kufizues, qasja, formati dhe përmbajtja e punës profesionale janë të pamjaftueshme, gjë që redukton mundësitë për efektet pozitive të këshillimit. Përkatesisht, këshillimi në një grup prej deri në 20 prindër në afate të përcaktuara saktësisht është një qasje e kufizuar që nuk ka individualizim.

22 Ligji për Shëndetin Mendor - teksti i qartë - (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr.71 / 07, 150/15)

23 OSBE 2019, “**Të kuptuarit e mekanizmave referues** për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që çojnë në terrorizëm: Vazhdimi i sfidave dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut - **Fokusi në Evropën Juglindore**”

Hisar dhe Prilep, si dhe tre qendra të specializuara për shëndetin mendor të fëmijëve dhe të rinjve (dy në Shkup dhe një në Manastir). Mbrojtja e shëndetit mendor të individëve me sëmundje mendore bazohet në mbështetjen e komunitetit ku ata jetojnë, ndërsa këshilli komunal krijon një Komitet për Shëndetin Mendor për çështje me interes për personat me sëmundje mendore. Sipas ligjit, Komisioni kryen këto aktivitete: monitoron situatën me mbrojtjen e të drejtave të personave me sëmundje mendore, shqyrton ankesat e njerëzve me sëmundje mendore dhe propozon masa për autoritetet kompetente, propozon masa për përmirësimin e kushteve për strehimin dhe kujdesin për personat me sëmundje mendore tek autoritetet kompetente dhe kryen aktivitete të tjera në përputhje me ligjin.²⁴ Megjithatë, puna e këtyre komisioneve nuk është e pranuar dhe e dukshme në nivel lokal.²⁵

3.7. Komunitetet fetare

Dy komunitetet më të mëdha fetare, Kisha Ortodokse e Maqedonisë dhe Bashkësia Fetare Islame mund të luajnë role shumë të rëndësishme si pjesë e sistemit me shumë agjenci për parandalimin e radikalizmit në nivel lokal, pasi radikalizmi me motive fetare është një nga rreziqet e përcaktuara. Përfshirja e bashkësive fetare në sistem ofron mundësinë për arsimim të mëtijshëm, demistifikimin e narrativave ekstremiste fetare dhe ndërtimin e alternativave bindëse dhe të kundërta. Diskutimet në tryezat e rrumbullakta të organizuar nga OSBE dhe Komiteti Nacional për LKEDH dhe LKT kanë treguar se komunitetet besojnë se autoritetet fetare mund dhe duhet të luajnë një rol konstruktiv në parandalimin e radikalizmit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm në dy nivele: (i) nëpërmjet punës me familjet; dhe (ii) përmes edukimit të të rinjve dhe ofrimit të interpretimeve alternative ndaj mësimave dhe rrëfimeve të propaganduara nga disa përkrahës ekstremistë të Islamit apo Krishterimit. Udhëheqësit fetarë duhet të konsiderojnë t'u qasen familjeve pasi disa probleme që përjetohen në marrëdhëniet familjare mund të bëhen një faktor kontribues për rrugën e një individi drejt radikalizmit. Puna me familjet është vendimtare për të zhvilluar një kulturë të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndëretnik dhe duhet të luajë një rol aktiv në krijimin e narrativave që ofrojnë një interpretim mejnstrim të fesë që do të parandalonte përhapjen e një ideologjie radikale.

²⁴ Ibid

²⁵ Bornarova Suzana and Bogoevska Natasha (2018), *Raport mbi hartimin e kapaciteteve institucionale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm*, IOM

4. Modeli i referimit

Duke e marrë parasysh hartën e mësipërme të institucioneve, vlerësohet se ka kapacitete dhe struktura ekzistuese të cilat janë relevante për nevojën e krijimit të një modeli parandalues për referimin e individëve që janë në rrezik nga radikalizimi që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm. **Ky është një propozim për një model referimi që është ankoruar në nivelin e komunitetit dhe parashikon një strukturë me shumë-agjenci** që lejon vlerësimin e rrezikut dhe mbështetjen e individit nga perspektiva të ndryshme: psikologjike, arsimore, sociale, shëndetësore, kulturore, fetare etj. Parimet e punës së strukturës së propozuar bazohen në vendimmarrje të përbashkët dhe veprim të koordinuar. Për këtë qëllim, modeli i propozuar bazohet në bashkëpunimin ndërmjet agjencive të shumëfishta të përfshira, të cilat janë të strukturuar qartë dhe të rregulluara me një protokoll dhe marrëveshje konfidenciale, që përcakton rregullat për shkëmbimin e informacionit midis institucioneve në lidhje me mbrojtjen individuale dhe të të dhënave, duke përfshirë edhe dhënien e informacioneve konfidenciale agjencive të tjera jashtë sistemit të referimit.

Duke pasur parasysh se ka struktura ekzistuese në nivel komunal, siç janë organet koordinuese për dhunën në familje, organet koordinuese për delikuentë e të miturve, organi komunal i koordinimit për dhunën në shkollë, si dhe linja ndihmëse ekzistuese për dhunën, të cilat janë në dispozicion në nivel nacional dhe të operuar nga një CSO, si shtesë e shërbimeve të “off-ramp” në dispozicion në nivel komunal, **modeli i propozuar nuk parashikon krijimin e një organi të ri** por përmirësimin e fushëveprimit të punës së njërit prej këtyre organeve. Më i përshatshëm është organi koordinues për dhunën në familje, pasi është një mekanizëm me shumë agjenci me koordinim të veçantë të rregulluar dhe protokolle të nënshkruara midis institucioneve të përfshira. I vetmi dallim midis modelit të dhunës në familje dhe modelit parandalues për referim është roli i policisë. Duke e pasur parasysh se dhuna në familje është kriminalizuar, policia ka një rol të qartë në ekzekutimin e Kodit Penal në aktet e dhunës kundër autorëve. Në modelin parandalues për referimin e individëve, sjellja radikale që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm konsiderohet të jetë në hapësirën para-kriminale dhe për këtë arsye modeli i parandalimit duhet të përjashtojë policinë nga vlerësimi i drejtpërdrejtë i individëve, por të lejojë mbikëqyrjen e trendeve dhe

numrit të rasteve të mbështetura nga mekanizmi në komunën përkatëse dhe t'i adresojnë këto tendenca me një program parandalimi përmes policimit në komunitet, policisë rrugore, patrulluese dhe aktiviteteve të policisë moto-patrulluese. Nga ana tjetër, modeli i shumë-agjencive për dhunën në familje duhet të përmirësohet për të përfshirë rolin e shkollave dhe bashkësive fetare. Në këtë drejtim, agjencitë e përfshira janë komuna, qendrat sociale, qendrat shëndetësore dhe komunitetet fetare. Këto duhet të ofrojnë parandalim parësor për të ndërtuar qendreshmërinë e komunitetit dhe kohezionin social për t'i rezistuar apelit të radikalizimit të ndjekur me parandalim dytësor duke angazhuar palë të ndryshme të komunitetit për të hartuar plane mbështetëse për komunitetet potencialisht të radikalizuara dhe për të ofruar mbështetje psiko-sociale. Në nivelin operativ, ndryshe nga modeli për dhunën në familje, ku agjencitë e përfshira nuk takohen rregullisht, modeli parandalues për referimin e individëve të cënueshëm ndaj radikalizimit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm **do të ketë pikat e rregullta të takimeve dhe diskutimet mbi rastet në baza individuale** për t'u akorduar për hapat e përshtatshme të veprimit për rastet individuale. Kjo është e domosdoshme pasi që plani mbështetës nuk mund të kryhet vetëm nga një institucion, por është e nevojshme qasja “e tërë shoqërisë”.

Modeli është projektuar për të ofruar **mbështetjen e nevojshme politike në nivel kombëtar dhe lokal**. Pra, Komiteti Nacional për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm parashihet të ofrojë udhëzime strategjike, ndërsa në nivel lokal bordi strategjik i referimit i përbërë nga Kryetari i Këshillit Komunal, Sekretari i Përgjithshëm i Komunës dhe Shefi i departamenteve të punëve publike sigurojnë mbështetjen politike. Në këtë mënyrë, aktivitetet e sistemit të referimit do të jenë në përputhje me Strategjinë Nacionale për LKEDH (të siguruar nga Komiteti Nacional për LKEDH dhe LKT) dhe me objektivat, programin vjetor dhe buxhetin e komunës. Programi për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm mund të votohet nga Këshilli dhe mund të përfshijë masa dhe buxhet për aktivitetet e sistemit të referimit, funksionimin e tij dhe mbështetjen ndaj shërbimeve përmes të cilave zbatohen planet individuale të mbështetjes.

Komunikimi dhe bashkëpunimi ndërinstitutional duhet të rregullohet me një protokoll të përbashkët. Ky mund të jetë i njëjti protokoll midis institucioneve të angazhuara për qëllime të dhunës në familje, të

përmirësuara me përgjegjësitë dhe shkathtësitë që duhen zbatuar në vlerësimin e rrezikut të radikalizmit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm. Protokolli duhet të përcaktojë procedura të qarta që sigurojnë komunikim efektiv në të gjitha palët e multi-agjencive të përfshira në sistem, duke emëruar punonjës të specializuar të cilët pastaj marrin trajnimin dhe përvojën e nevojshme në trajtimin e çështjeve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Për të mbrojtur individin që hyn në sistemin e referimit dhe për të siguruar që ata do të mbështeten nga komuniteti për t'u bërë më të qendrueshëm ndaj radikalizmit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm, **është e nevojshme të përcaktohen rregullat për mbrojtjen e të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit** mbi vlerësimin individual të rrezikut nga perspektivat sociale, psikologjike dhe shëndetësore, si dhe procedurat për ruajtjen e të dhënave dhe menaxhimin ndërmjet anëtarëve të sistemit të referimit. Për këtë qëllim, modeli parandalues duhet “të dallojë informacionet origjinale të klasifikuara nga informacionet e ndjeshme që mund të ndahen me njëfarë maturie”.²⁶ Në këtë drejtim, informatat personale të ndjeshme për individët nuk mund të ndahen me organet e rendit në mënyrë që bashkëpunimi midis anëtarëve të mekanizmit dhe bashkëpunimi i individëve që kanë hyrë në sistemin e referimit nuk do të pengohet.²⁷ Prandaj, të gjithë anëtarët e modelit parandalues për referimin e individëve do të nënshkruajnë një marrëveshje *non-disclosure* për shkëmbimin e informacionit (ISA) që mbron individët me të cilët punojnë dhe të dhënat e tyre personale. Sipas ligjit, organet e zbatimit të ligjit nuk mund të ndajnë informacionin e klasifikuar me anëtarët e sistemit të referimit. Duke pasur parasysh se anëtarët e familjeve të personave të burgosur që bien në hapësirën para-kriminale mund të kenë nevojë të referohen në sistemin e parandalimit, ose mund të ketë raste të tjera kur organet e zbatimit të ligjit mund ta konsiderojnë të nevojshme për të shkëmbyer informacione, mund të vlerësohet si e përshtatshme për një anëtar të bordit strategjik të sistemit referues

26 EURAN, “Sfidat e përbashkëta të P/LKEDH në Ballkanin Perëndimor dhe në Bashkimin Evropian” Pril 2018, fq.8, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ranpapers/docs/ran_policy_practice_common_pcve_challenges_sofia_04042018_en.pdf.

27 EURAN Center of Excellence, “Doracak: Si të krijohet një strukturë shumë-agjencive që përfshin sektorët e kujdesit shëndetësor dhe social?,” 18-19 Maj 2016, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/ex-post-paper-handbook-ran-hsc-18-19-may-2016-copenhagen-dk_en.pdf.

për të marrë një leje sigurie për qëllimet e këtyre referimeve. Modeli parandalues duhet **të ofrojë mbështetje të ekspertëve për anëtarët e sistemit referues**. Mbështetja e ekspertëve mund të vendoset në nivel kombëtar dhe të jetë mbështetje e lëvizshme e sigurimit për sistemet referuese të bazuara në komunitet në të gjithë vendin. Në këtë mënyrë, organi nacional i koordinimit mund të luajë një rol të rëndësishëm në krijimin dhe mbajtjen e platformave parandaluese për të adresuar radikalizmin në nivel lokal duke e pasur parasysh se vendi është mjaft i decentralizuar.

Modeli parandalues duhet të njohë nevojat, interesin dhe përvojat e ndryshme të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave.²⁸ Duke e pasur parasysh se ka taktika të ndryshme për të rekrutuar gratë dhe burrat, roli i çështjeve gjinore dhe të identitetit mund të ketë një ndikim të fortë në trajektoret e radikalizmit ndaj dhunës.²⁹ Kjo krijon një domosdoshmëri për masat për të parandaluar radikalizmin që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm, duke i përfshirë **mekanizmat e referimit, për të integruar një perspektivë gjinore**.³⁰

28 OSCE and ODIHR, "Rekomandimet dhe Zbulime: Përfshirja Gjinore në Përgjigjet Operacionale në VERLT," 22-23 Nëntor 2016, <https://www.osce.org/secretariat/305056?download=true>.

29 RAN Policy Paper, Zhvillimi i një kuadri parandalues lokal dhe parime udhëzuese, EU RAN Centre of Excellence, Nëntor 2016, p. 14, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/policy_paper_developing_local_prevent_framework_guiding_112016_en.pdf.

30 Për një diskutim të dinamikës gjinore dhe rolit të grave në VERLT dhe P/CVERLT, shiko, e.g., Irene Ndung'u dhe Mothepa Shadung, "A mund të përmirësojë qasja gjinore përgjigjet ndaj ekstremizmit të dhunshëm?," Institute for Security Studies, Shtator 2017, <https://issafrica.s3.amazonaws.com/site/uploads/aitwr-5.pdf>; Iffat Idris dhe Ayat Abdelaziz, "Gratë dhe ekstremizmi i dhunshëm: Raporti i Huluntimit - Helpdesk," GSDRC Help Desk Research Report, 2017, http://www.gsdr.org/wp-content/uploads/2017/05/HDR_1408.pdf; Emily Winterbotham dhe Elizabeth Pearson, "Qytetet e ndryshme, tregimet e përbashkëta: Një studim i pesë vendeve që sfidojnë supozimet rreth grave myslimane dhe ndërhyrjeve në LKEDH," RUSI Journal, 30 Nëntor 2016, <https://rusi.org/publication/rusi-journal/different-cities-shared-stories-five-country-study-challengingassumptions>; dhe Naureen Choudhury Fink, Sara Zeiger, and Rafia Bulai, Bota e Burrit: Eksplorimi i roleve të grave në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, Hedayah dhe Global Center on Cooperative Security, Prill 2016, http://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2016/07/AMansWorld_FULL.pdf.

4.1 Struktura e modelit të referimit, roli dhe kompetencat

Struktura e modelit të referimit të propozuar në vijim është bërë nga disa komponentë që kanë rolet dhe kompetencat specifike në model. Emërimi i anëtarëve të komponentëve të ndryshëm të modelit të referimit propozohet të bëhet nga institucionet që janë hartuar si kompetente për të qenë pjesë e sistemit parandalues. Emërimi propozohet të bëhet nga menaxhmenti i institucioneve pjesëmarrëse, dhe me kërkesë të Kryetarit dhe/ose Bordit Strategjik.

Komiteti Nacional për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit në modelin e propozuar ofron mbështetje politike, përkrahje profesionale dhe vepron si një ndërlidhës me Bordin Strategjik të sistemit referues. Komiteti Nacional siguron mbështetjen e nevojshme politike në nivel qendror/nacional duke siguruar që aktivitetet e sistemit të referimit të bazuar në komunitet të veprojnë në përputhje me Strategjinë Nacionale për LKEDH, si dhe koordinon dhe drejton aktivitetet e Bordit Strategjik që janë nga strategjitë nacionale në këtë fushë për të përcaktuar dhe zbatuar masat e duhura për LKEDH. Komiteti parashtohet të jetë në gjendje të ofrojë mbështetje profesionale përmes Koordinatorit Nacional dhe Zëvendëskoordinatorit për LKEDH, por edhe përmes një grupi të ekspertëve të propozuar të psikologëve, punëtorëve social, teologëve dhe profesionistëve të shëndetit mendor që janë të specializuar për radikalizmin që mund çojë në ekstremizëm të dhunshëm. Komiteti Nacional pritet gjithashtu të mbajë lidhje me Bordin Strategjik të sistemit referues në nivel lokal, duke mbledhur të dhëna mbi tendencat e radikalizmit, nevojat për trajnim dhe ngritjen e vetëdijes dhe përmirësimin e shërbimeve publike të nevojshme për të forcuar rezistencën ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Së fundmi, Komiteti Nacional duhet të krijojë një kornizë monitorimi dhe vlerësimi që do të gjenerojë të dhëna, përfshirë gjininë dhe moshën, mbi tendencat dhe duhet të përcjellë numrin dhe gatishmërinë e referimeve (duke vënë në dukje llojet e ndërhyrjeve ose komponentët e planeve më të gjëra mbështetëse) me të cilat ofruesit e shërbimeve janë përfshirë dhe përfshijnë indikatorë të mundshëm të rezultateve të tilla si ato që lidhen me punësimin, rezultatet e arsimit, rezultatet shëndetësore dhe pjesëmarrja në çështjet shoqërore dhe të komunitetit. Kjo duhet të vendoset në nivel nacional, ndërsa bordet strategjike të nivelit lokal duhet të mbledhin të dhëna nga niveli lokal. Në këtë mënyrë i gjithë modeli i parandalimit do të gjene-

rojë të dhëna për performancën dhe rezultatet, jo vetëm për aktivitetet e zbatuara.

Ekipi i Ekspertëve do të ndërmarrë vlerësime të përshtatshme të rreziikut dhe do të sigurojë mbështetje mobile për punën e bordeve referuese në nivel lokal. Ekipi parashikohet të përbëhet nga profilet e mëposhtme: psikolog, punëtor social, punëtor shëndetësor i sensibilizuar ndaj fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm, teolog me një kuptim mbi narrativat ekstremiste, një specialist i cili mund të identifikojë nevojat e trajnimit në krahun e djathtë dhe të majtë të ekstremizmit, si dhe një punonjës rinor i specializuar në mentorimin e të rinjve në nevojë. Bordet e referimit do të duhet të kërkojnë mbështetje që mund të vijnë në formën e trajnimit, këshillimit ose konsulencës. Kërkesa duhet të drejtohet tek Komiteti Nacional për LKEDH dhe LKT i cili vendos kur dhe si ofrohet ekspertiza.

Bordi Strategjik ofron udhëzime për marrëdhëniet me publikun, rritjen e ndërgjegjësimin të komunitetit, ngritjen e kapaciteteve të bordeve të referimit, përcakton prioritetet dhe vendos për konfidencialitetin, shkëmbimin e informacionit, moszbulimin e informacionit dhe ndan informacionin anonim për rastet, tendencat dhe zhvillimet në komunë me organet e rendit dhe Komitetin Nacional për LKEDH dhe LKT. Bordi Strategjik gjithashtu vendos për buxhetet dhe themelimin e buxheteve të reja, ose zgjerimin e fushave të shërbimeve ekzistuese që forcojnë qëndrueshmërinë e komunitetit ndaj radikalizmit. Në modelin e propozuar, Bordi Strategjik ndan informacionin në përputhje me marrëveshjen e përbashkët të shkëmbimit të informacionit dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave me policinë dhe policia ndan informacionin përkatës (jo të klasifikuar) për parandalim me Bordin Strategjik, në pajtim me Ligjin për Qasjen e Lirë në informata. Në modelin e propozuar, Bordi Strategjik është gjithashtu përgjegjës për grumbullimin e të dhënave për çështjet që kanë të bëjnë me ekstremizmin e dhunshëm. Këto përfshijnë numrin e rasteve, burimet ekzistuese dhe kapacitetet e tjera të atyre që janë përfshirë në mekanizëm, si dhe nivelet e besimit që anëtarët e mekanizmit kanë brenda komuniteteve përkatëse.

Bordi Strategjik parashihet të përbëhet nga tre anëtarë nga komuna: Sekretari i Përgjithshëm i Komunës, Kryetari i Këshillit Komunal dhe Shefi i Sektorit/Departamentit për Punë Publike. Sekretari i Përgjithshëm i

komunës do të mbajë kompetencat për çështjet ligjore, mbrojtjen e të dhënave, protokollet ndër-agjencionale për bashkëpunim dhe koordinim; hartimi i planeve lokale të veprimit për zbatimin e Strategjisë për LKEDH; hartimin e një plani vjetor dhe raporteve të punës dhe dorëzimin e tyre në Komitetin Nacional. Kryetari i Këshillit Komunal është i përfshirë pasi ky është organi i komunës që vendos për programin komunal ku përfshihen aktivitetet dhe shërbimet e përfshira në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Kryetari i Këshillit Komunal gjithashtu vendos për buxhetin komunal të nevojshëm për funksionimin e bordit të referimit, ofrimin e shërbimeve, ngritjen e vetëdijes dhe trajnimin. Udhëheqësi i Sektorit/Departamentit për punë publike (arsim, kujdes social, shëndetësi) është anëtar i tretë i Bordit Strategjik dhe ofron analiza dhe monitorim të situatës në fushën e ekstremizmit të dhunshëm në komunë; koordinimi i aktiviteteve të anëtarëve të bordit të referimit dhe ofruesve të shërbimeve; dhe është përgjegjës për planifikimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të aktiviteteve nga bordi i referimit dhe ofruesit e shërbimeve në lidhje me zbatimin e planeve të mbështetjes. Nëse është e nevojshme, anëtarësimi i Bordit Strategjik mund të zgjerohet tek përfaqësuesi i policisë dhe një përfaqësues i Komisionit për Marrëdhënie Ndëretnike ose ndonjë organ tjetër i vlerësuar si i rëndësishëm për mbështetjen politike të funksionimit të sistemit të referimit të individëve të ekspozuar ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Bordi i Menaxhimit të Lëndëve/Bordi i Vlerësimit të Lëndëve është në thelb të modelit të propozuar dhe përbëhet nga gjashtë profesionistë (një psikolog (p), një punonjës social (p), një mjek (p), dy përfaqësues të bashkësive fetare, të dy besimet më të mëdha - Krishterimi dhe Islami (p) dhe një anëtar i komunitetit (që përfaqëson bashkësinë specifike etnike të cilës i përket individ i referohet modelit parandalues) Pesë nga gjashtë profesionistë janë anëtarë të përhershëm të bordit ndërsa përfaqësuesi i komunitetit të ndërrueshme në varësi të individit që vlerësohet dhe mbështetet nëpërmjet modelit parandalues.

Individët e tërhequr në mjediset ekstremiste janë diagnostikuar që më parë me një sërë problemesh komplekse psikologjike. Kompetencat e bordit janë për të emëruar një menaxher të lëndëve dhe një ekip; të kryen një vlerësim të rrezikut dhe të vendos mbi një plan mbështetës për individin që ka hyrë në sistemin e referimit. Kur një person hyn vullnetarisht në një sistem referimi, anëtarët profesionistë të menaxhimit të

lëndës/bordi i vlerësimit caktojnë një menaxher të lëndës nga anëtarët e bordit dhe dy anëtarë të ekipit të tij/saj që do të kryejë një vlerësim psiko-sociologjik të vlerësimit të rrezikut të radikalizmit për personin e referuar. Bazuar në vlerësimin dhe paraqitjen e gjetjeve të Bordit, anëtarët vendosin se ku të referojnë individin dhe çfarë lloj mbështetjeje duhet të ofrojë mekanizmi, të përcaktojnë se si do të vlerësohet monitorimi dhe vlerësimi i progresit dhe do të ngarkojë menaxherin e lëndës me një plan për raportimin e rezultateve.

Menaxheri i lëndës është një nga anëtarët e Bordit për menaxhimin/vlerësimin e lëndëve të Bordit në modelin e propozuar. Të gjithë anëtarët mund dhe do të jenë menaxherët të lëndëve për raste të ndryshme. Menaxheri i lëndës punon në një ekip së bashku me dy anëtarë të tjerë të bordit. Menaxheri i lëndës drejton dhe organizon punën e ekipit të ekspertëve; kryen vlerësimin e rasteve, siguron vlerësimin, zhvillon planin individual të mbështetjes, duke përfshirë qëllimet specifike, detyrat dhe zbatuesit e detyrave, dhe në fund mbikëqyr zbatimin.

Pasi të kryhet vlerësimi thelbësor i rrezikut psiko-social dhe Bordi i Menaxhimit të Referimit vendos për planin e mbështetjes, individi i referohet **ofruesve të shërbimeve** për këshillim, trajnim, rrjetëzim etj. Hulumtimi i CRPM mbi perceptimet e punëtorëve *frontline* dhe zyrtarëve të komunitetit nga Shkupi, Kumanova, Tetova dhe Gostivari mbi radikalizmin që çon në ekstremizëm të dhunshëm³¹ tregon se nxënësit e shkollave të mesme luftojnë me problemet e identitetit, integritimit e dështuar, ndjenjat e tjetërsimit, marginalizimit dhe diskriminimit që bëhen arsye kryesore pse të rinjtë priren të pranojnë përhapjen e ideologjive radikale dhe përdorimin e dhunës; kjo gjithashtu sugjeron që ata nuk kanë aftësi për zgjidhjen e problemeve, aftësitë sociale dhe aftësitë kritike të të menduarit me kontroll të ulët të impulsit. Për këtë arsye, shërbime të ndryshme dhe ofrues të shërbimeve të tilla si psikologët, punonjësit e shëndetit mendor, qendrat rinore dhe qendrat sportive mund të ndihmojnë individët e pambrojtur në kanalizimin e ndjenjave dhe frustrimeve, si dhe lehtësimin e rrjetëzimit dhe përfshirjes sociale. Në këtë mënyrë, shenjat e paralajmërimit të hershëm të radikalizimit do të identifikohen dhe zbuten. Ofruesit e shërbimeve në këtë kontekst mund të jenë nga

31 Filip Stojkovski, Ivan Stefanoski, Kristijan Aleksovski (2019), *Studimi bazë: Perceptimet e punonjësve të shkollave frontline dhe zyrtarëve të komunitetit nga Shkupi, Kumanova, Tetova dhe Gostivari mbi radikalizmin që çon në ekstremizëm të dhunshëm*, ed. Marija Risteska, CRPM


institucionet publike, kompanitë dhe CSO-të që ofrojnë programe dhe aktivitete që mund të zbusin faktorët që i bëjnë anëtarët e komunitetit të preکشëm për të pranuar përhapjen e ideologjive radikale dhe përdorimin e dhunës.

Ekipet e Veprimit të Komunitetit (EVK) për LKEDH janë themeluar në tri pilot komuna: Çair, Kërçovë dhe Gostivar³². Roli i EVK përfshin programe tipike parandaluese të dizajnuara për të ndërtuar qendrueshmërinë e komunitetit dhe kohezionin social për t'i rezistuar apelit të radikalizmit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm. Këto ekipe i bëjnë propozime këshillit komunal duke përfshirë vendimet, programet dhe aktet e tjera që janë me rëndësi për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm. EVK-të lehtësojnë diskutimet me Këshillin Komunal mbi vendimet e propozuara, duke përfshirë një plan të propozuar financiar për zbatimin e aktiviteteve; të rrisin ndërgjegjësimin për kërcënimin e ekstremizmit të dhunshëm në lagje; dhe të sigurojnë informacion publik për të gjitha çështjet e rëndësishme për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Grupet Punuese të Komunitetit (GPK) janë formuar në komunat e Kumanovës, Velesit, Gazi Babës dhe Tetovës. Një nga rolet e tyre është zbatimi i aktiviteteve edukative dhe promovimi i të menduarit kritik, opozitës dhe protestës jo të dhunshme, shkëmbimi i informacionit dhe organizimi i ngjarjeve, diskutimeve publike, debateve që rrisin ndërgjegjësimin dhe qendrueshmërinë e komunitetit ndaj radikalizmit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm.³³

32 Mekanizmi është zhvilluar nga Search for Common Ground në kuadër të projektit “Forcimi i qendrueshmërisë së komuniteteve lokale ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoni” financuar nga Ambasada Britanike dhe Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup

33 Mekanizmi është zhvilluar nga Qendra Civile për Liri në kuadër të projektit “Komunitetet kundër ekstremizmit të dhunshëm”, financuar nga Ambasada e SHBA



EKIPET E VEPRIMIT NË KOMUNITET

MBAN LIDHJE ME BORDIN STRATEGJIK
 PROPOZON THEMELIMIN E SHËRBIMET TË REJA
 KËSHILLON PËR DIVERSIFIKIMIN E SHËRBIMEVE TË DISPONUESHME
 KËSHILLON PËR FINANCIMIN E CAKTUAR NGA KOMUNA
 PËR AKTIVITETET P/LKEDH

EVK
GPK

GRUPET PUNUESE NË KOMUNITET

MUNDËSOJNË SHËRBIME PËR ZBATIMIN E PLANIT INDIVIDUAL
 MUNDËSOJNË MBËSHTETJE TË KOMUNITETIT PËR ZBATIMIN E PLANIT INDIVIDUAL

4.2. Procesi i referimit

Bordi i Referimit duhet të mblidhet së paku një herë në muaj kurse takime të jashtëzakonshme mund të mbahen kur të jetë e nevojshme. Lokacioni i takimeve të tyre mund të jetë në komunë ose në mjediset e ndonjë prej anëtarëve të bordit. Përndryshe, rekomandohet që Bordi Strategjik të takohet në ambientet e komunës.

Duke e pasur parasysh se një qasje e-tërë-shoqërisë zbatohet për referimin e individëve të prekshëm ndaj radikalizmit në një mënyrë që jo vetëm që synon grupet e cënueshme, por është e drejtuar ndaj të gjithë komunitetit, procesi i referimit zbatohet në tre faza.

Faza 1: Iniciimi

Faza e parë është iniciimi, e cila përfshin referimin e një personi në mekanizmin e referimit të ndjekur nga një takim fillestar. Iniciimi mund të kryhet në mënyra të shumëfishta si p.sh. përdorimi i një formulari online, thirrja në linjë hotline ose referimi nga një grup i ndryshëm i palëve të interesuara tek mekanizmi i referimit.

Hapi 1: Referimi në sistem

Referimi me formularë online: Formulari i referimit mund të gjendet në faqen e internetit të komunës me një deklaratë të qartë se referimi është tërësisht konfidencial dhe se vetëm Bordi i Referimit do të ketë qasje në informacionin e dhënë në mekanizëm. Referimi mund të trajtohet si anonim, por duhet të sigurohen informatat për kontakt në mënyrë që Bordi i Referimit të mund të kontaktojë personin që e bën kërkesën. Për më tepër, duhet të ketë një garanci të qartë se informacioni nuk do të ndahet me organet e zbatimit të ligjit apo agjencitë e inteligjencës përveç nëse ekziston një rrezik i drejtpërdrejtë për sigurinë publike, në të cilin rast komuna është e detyruar të bashkëpunojë me organet e rendit publik. Formulari i referimit duhet gjithashtu të përmbajë informacion mbi atë që vijon pas referimit. Kjo përfshin një përshkrim të procesit që nënvizon se individ që është referuar do të trajtohet dhe nëse ai/ajo pajtohet të mbështetet përmes sistemit referues, atëherë do të ndërmerret një vlerësim i rrezikut dhe do të zhvillohet një plan individual i mbështetjes, i përshtatur për nevojat e individit të referuar.

Hotline / Helpline: me qëllim të iniciimit të sistemit të referimit, komuna mund të hapë një linjë të posaçme telefonike lokale - *hotline* ose një linjë *helpline* përmes së cilës ajo mund të “sigurojë mbështetje dhe këshilla të rëndësishme psikologjike për familjet, të afërmit dhe miqtë e individëve që janë të lidhur me ekstremizmin e dhunshëm”.³⁴ Përndryshe, komuna mund të përdorë një linjë ekzistuese, për shembull atë që është e dedikuar për të raportuar dhunën në familje. Aktorë të ndryshëm, siç janë organizatat e shoqërisë civile, veprojnë këto me këto linja *hotline/helpline* dhe mund të kenë nevojë t’i nënshtrohen trajnimit shtesë për ekstremizmin e dhunshëm. Rekomandohet përdorimi i këtyre linjave telefonike *hotline/helpline* në gjuhët maqedonase, shqipe, turke dhe rome për të krijuar besim dhe mbështetje psikologjike dhe për të ofruar më mirë këshillime profesionale se si të veprohet dhe te kush të drejtohet në një situatë të caktuar.

Referimi nga një institucion: kur një mësues, një mjek ose një trajner në një klub sportiv, vëren se një individ mund të jetë i prekshëm nga radikalizmi atëherë ai/ajo mund ta telefonojë komunën, të shkruajë një email ose të përdorë një formular referimi online për të referuar këtë person në sistemin për mbështetje. Këto opsione mund të përfshijnë persona nga klubet sportive, qendrat fetare ose të tjera të komunitetit, ose nga profesionistë *frontline* si mësuesit, punëtorët me rini ose punëtorët socialë duke përdorur mekanizmat tashmë në dispozicion brenda sistemit të tyre të veprimit. Në këtë drejtim, rekomandohet që shkollat të përfshijnë mundësinë për nxënësin që t’i referohet modelit parandalues si një nga masat pedagogjike.

Që ky kanal i referimit të institucionalizohet formalisht, shkollat duhet të ndryshojnë statutin e shkollës. Nga ana tjetër, qendrat për punë sociale mund të vendosin për masa të ndryshme dhe t’i referojnë përfituesit e shërbimeve të ndryshme duke përfshirë modelin komunal parandalues për mbështetje më të plotë.

Që të funksionojnë të gjitha këto kanale referimi, është e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit në komunitet për të qenë në gjendje të njohë sjelljet që mund të tregojnë ndjeshmërinë ndaj radikalizmit. Në të njëjtën kohë është pranuar se mësuesit, punonjësit socialë, punëtorët shëndetësorë, udhëheqësit fetarë, sportistët, profesionistët e kulturës dhe profesionistët

³⁴ OSCE 2019, “**Të kuptuarit e Mekanizmave Referues për Parandalimin dhe Luftimin e Ekstremizmit dhe Radikalizmit të Dhunshëm që çojnë në Terrorizëm: Drejtimi i sfidave dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut - Një fokus në Evropën Juglindore**”

stët e tjerë kanë nevojë për trajnim specifik për të kuptuar ekstremizmin e dhunshëm dhe rreziqet që lidhen me to.

Hapi 2: Takimi fillestar

Pasi të jetë referuar një individ, Bordi i Referimit duhet të mbajë një takim fillestar. Në takimin e parë individit duhet të inkurajohet (dhe të nxitet) që të përfitojë nga ndërhyrjet dhe mbështetja e ofruar përmes programit. Qëllimi i takimit është që të merret pëlqimi vullnetar nga individit. Kur individit i referuar është i mitur, duhet të kërkohet pëlqimi i prindit ose kujdestarit në mënyrë që ai ose ajo të vlerësohet dhe të marrë ndonjë ndërhyrje përmes mekanizmit.

Sapo individit i referuar të ketë pranuar të marrë pjesë në sistem, atëherë fillon faza e dytë.

Faza 2: Vlerësimi

Faza e dytë është përqendruar në prodhimin e një rreziku jodiskriminues dhe ka nevojë për vlerësimin e individëve që janë referuar në sistemin referues dhe janë pajtuar të mbështeten nga komuniteti. Në këtë fazë, mjetet e vlerësimit (të cilat duhet të zhvillohen sipas secilit kontekst të veçantë) aplikohen për të vlerësuar rreziqet e radikalizmit dhe për të identifikuar nevojat për të zvogëluar cënueshmërinë ndaj radikalizmit me qëllim të zhvillimit të një plani mbështetës për individin.

Hapi 1: Vlerësimi i rrezikut

Kuadri i vlerësimit përfshin intervista me individët e referuar, anëtarët e familjes, kolegët dhe mësuesit; vëzhgimet e rrjeteve sociale; dhe dosjet e lëndëve të punëtorëve socialë, shëndetësorë, ose të punëtorëve të shkollave. Këto burime sigurojnë një vlerësim multi-dimensional dhe objektiv të një individit. Meqenëse disa nga burimet janë sekondare, duke u mbështetur në dosjet dhe punën e institucioneve të ndryshme të përfshira në model me individin para se ai të referohet në sistemin referues, institucionet duhet të nënshkruajnë një marrëveshje për ndarjen e informacionit që rregullon privatësinë e të dhënave personale të ndara në mes të anëtarëve të bordit të referimit. Një draft marrëveshje për shkëmbimin e informacionit është përfshirë në Aneksin 1.

Vlerësimi përfshin zbatimin e metodave të bazuara në prova, të cilat kombinojnë trajtimin e traumave me vlerësimin e rrezikut dhe metodat

terapeutike të tilla si Psikologjia e Jetës, Përgjegjësia nga Rreziku etj. Vlerësimi duhet të përcaktojë faktorët që mund të ndikojnë në cenueshmërinë e një individi ndaj radikalizmit. Për këtë qëllim, vëllimi i literaturës mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm tregon se nuk ka asnjë faktor, por një kombinim faktorësh që favorizojnë vulnerabilitetin ndaj radikalizmit. Një tregues i përbashkët për radikalizmin është ndryshimi i individit në sjellje, ideologji dhe/ose rrjetet sociale.³⁵ Megjithatë, në disa modele të intervenimit zbatohen disa mjete që përqendrohen në mënyrë specifike në ekstremizmin e dhunshëm. Për shembull, TRAP 18 (Protokolli i Vlerësimit të Radikalizmit Terrorist) ekziston për të përcjellë parashikimin afatgjatë të aktorëve individualë; HCR 20 është një model i përdorur zakonisht për të vlerësuar rrezikun e dhunës pa një fokus të veçantë në dhunën ekstremiste; ndërsa VERA-2 merr në konsideratë aspektet sociale dhe kontekstuale të mjedisit të individit dhe MLG (udhëzim multi-nivelor) është një grup i udhëzimeve të strukturuar të gjyqimit profesional për vlerësimin e dhunës me bazë grupore që përbëhet nga katër fusha të faktorëve të rrezikut: (1) Individual, (2) Grupor-Individual, (3) Grupor dhe (4) Grupor-Shoqërorë. Megjithatë, vlerësohet se të gjitha këto mjete të vlerësimit të rrezikut lidhur me ekstremizmin e dhunshëm janë të reja, ende nuk janë verifikuar dhe kanë nevojë për vlerësim të mëtejshëm përpara se të rekomandohen të transferohen diku tjetër.

Në vlerësim, mund të përfshihen të gjithë anëtarët e bordit të referimit ose një ekip vlerësimi i përbërë nga menaxheri i lëndës dhe dy anëtarë të tjerë (varësisht nga rasti). Për të dyja opsionet ekziston nevoja për të emëruar një menaxhues të lëndëve para fillimit të vlerësimit të rrezikut. Menaxheri i lëndës do të menaxhojë vlerësimin, zhvillimin e planit të mbështetjes, zbatimin e planit të mbështetjes dhe monitorimin dhe raportimin e progresit të arritur. Menaxheri i lëndës është gjithashtu anëtar i bordit të referimit. Menaxheri i lëndës shërben si pika e vetme e kontaktit me individin, familjen dhe të tjerët në bashkësinë lokale.³⁶ Një pikë e vetme e kontaktit shmang rrezikun e minimit të efikasitetit dhe

35 GCTF, Iniciativa për të Adresuar Ciklin Jetësor të Radikalizmit të Dhunshëm, Memorandumin e Neuchâtel mbi Praktikën e Mira për Drejtësinë e të Miturve në Kontekstin Kundër Terrorizmit, <https://theiij.org/wp-content/uploads/English-Neucha-tel-Memorandum-on-Juvenile-Justice.pdf>

36 OSCE 2019, *“Të kuptuarit e Mekanizmave Referues për Parandalimin dhe Luftimin e Ekstremizmit dhe Radikalizmit të Dhunshëm që çojnë në Terrorizëm: Drejtimi i sfidave dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut - Një fokus në Evropën Juglindore”*

besimit në mekanizmin që mund të paraqitet nëse anëtarët e bashkësisë lokale qasen nga individë të shumtë në lidhje me një rast të veçantë.³⁷

Rezultati i vlerësimit duhet të çojë në zhvillimin e një plani mbështetës që është hartuar posaqërisht për nevojat specifike të individit të vlerësuar.

Hapi 2: Zhvillimi i planit të mbështetjes

Plani i mbështetjes është i përshtatur sipas dobësive të identifikuara dhe duhet të marrë parasysh moshën, gjininë, prejardhjen kulturore, karakteristikat socio-kulturore të bashkësisë që i takon individi, si dhe të bazohet kryesisht në faktorët e rrezikut që janë identifikuar në vlerësimi. Plani i mbështetjes duhet të përshkruajë shërbimet për të cilat është referuar individi, frekuencën që individi duhet t'i ndjekë dhe objektivat afatshkurtra dhe afatgjata të planit të mbështetjes, si dhe metodat e monitorimit dhe grumbullimit të të dhënave për matjen e progresit të mbështetjes që i jepet individit.

Shërbimet që duhet të konsiderohen të përfshihen në planin e mbështetjes janë: familja ose këshillimi psikosocial; programe mentorimi (ideologjike dhe/ose teologjike); trajnime dhe rekreacion (sport, art, muzikë, teatër, aftësi profesionale, duke rritur aftësitë e punësimit, asistencë për vendosjen e punës); ndërmjetësimi në konflikte, menaxhimi i zemërimit, programet e tolerancës dhe menaxhimit të diversitetit; dhe së fundmi për disa individë trajtimi i varësisë (droga, alkooli, bixhozi etj). Në shumë komuna këto shërbime nuk ekzistojnë dhe për këtë arsye ekipet e veprimit të komunitetit duhet t'i rekomandojnë bordit strategjik ngritjen e shërbimeve shtesë sipas nevojave.

Shërbimet në dispozicion në komunat ku implementohet projekti Edukimi për Parandalimin (Educate to Prevent) janë identifikuar dhe një listë shërbimesh është përgatitur dhe paraqitur në Aneksin 2 të modelit.

Faza 3: Mbështetja

Faza e mbështetjes është e fundit dhe përfshin zbatimin e planit të mbështetjes që është zhvilluar në fazën e mëparshme dhe monitorimin dhe vlerësimin që merr në konsideratë progresin e arritur. Faza e

³⁷ EU RAN Center of Excellence, "Doracak mbi mënyrën e krijimit të një strukture multi-agjenci", online: https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-h-and-sc/docs/ran_hsc_policy_mawr_report_sarma_26032019_en.pdf

mbështetjes është më e rëndësishmja pasi që në këtë fazë, të gjitha dobësitë ndaj radikalizmit janë të adresuara. Suksesi i kësaj faze mund të çojë në përmbysjen e proceseve të radikalizmit në një komunitet dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm si një fenomen.

Hapi 1: Zbatimi i planit të mbështetjes

Zbatimi i planit të mbështetjes menaxhohet nga menaxheri i lëndës, por realizohet nga një numër i profesionistëve, praktikantëve (punëtorëve socialë, shëndetësorë dhe rinorë, mentorëve fetarë ose të tjerë, sporteve, jetës, trajnerëve të tjerë, mësimdhënësve, aktivistëve të OJQ-ve etj) duke punuar në shërbimet të bazuara në komunitete. Këto palë të interesuara mund të japin intervenime të ndara ose të gjithë planin e mbështetjes. Mbështetja e ofruar përmes sistemit të referimit do të dorëzohet në një afat kohor të paracaktuar. Megjithatë, procesi i mbështetjes së individit të pambrojtur ndaj radikalizmit do të monitorohet dhe plani mbështetës do të përshtatet në përputhje me nevojat e përfituesit, përfshirë një rishikim të mundshëm të afatit kohor.

Hapi 2: Raporti mbi progresin

Një plan gjithëpërfshirës për monitorimin dhe vlerësimin (M&V) është jetik për të siguruar mbështetjen efektive të individëve të cenueshëm ndaj radikalizmit. Një kornizë M&V duhet të përcjellë, duke përfshirë sipas gjinisë dhe moshës, numrin dhe disponimin e referimeve (duke vënë në dukje llojet e ndërhyrjeve ose komponentëve të planeve më të gjera mbështetëse) me të cilat janë përfshirë ofruesit e shërbimeve dhe përfshijnë indikatorët e disponueshëm të rezultateve siç janë ato që lidhen me punësimin, arsimin, shëndetësinë dhe pjesëmarrjen në çështjet shoqërore dhe të komunitetit.³⁸

Qëllimi është mbledhja e të dhënave statistikore, por edhe të dhënave cilësore për individët e referuar, përfshirë informacionin e mbledhur nga pyetësorët e plotësuar nga individ i referuar, të afërmit dhe kolegët. Kjo do të mundësojë informata mbi trendet e analizës mbi numrin, karakterin dhe nivelin e incidenteve të dhunshme dhe retorikën ekstremiste të përdorur nga palë të ndryshme të interesit në komunitet; por edhe reagi-

38 OSCE 2019, *"Të kuptuarit e Mekanizmave Referues për Parandalimin dhe Luftimin e Ekstremizmit dhe Radikalizmit të Dhunshëm që çojnë në Terrorizëm: Drejtimi i sfidave dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut - Një fokus në Evropën Juglindore"*

min që komuniteti ka dhënë në luftimin e këtij fenomeni. Këto përpjekje do të kontribuojnë në zgjidhjen e një problemi të theksuar shpesh për politikëbërësit e LKEDH-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut, që është mungesa e të dhënave të besueshme dhe të qëndrueshme. Që nga miratimi i Strategjisë Kombëtare për LKEDH në shkurt të vitit 2018, komunat janë bërë përgjegjëse për kontributin në përgjigjen institucionale ndaj këtij fenomeni. Autoriteteve komunale u kërkohet të përgatisin plane veprimi lokale dhe së bashku me ekipet lokale të veprimit të kontribuojnë në zbatimin e Strategjisë Nacionale për LKEDH. Megjithatë, gjetjet e hulumtimit të CRPM tregojnë se komunat janë shumë pak në dijeni të rolit të tyre në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.³⁹

Ngritja e një sistemi për grumbullimin e të dhënave dhe mbajtjen e të dhënave në nivel lokal, si dhe raportimi i rregullt dhe analiza e tendencave në nivel kombëtar do të ishte kritike. Për këtë qëllim dhe në mënyrë që reagimi ndaj ekstremizmit të dhunshëm të jetë efektiv, është e rëndësishme të krijohen lidhje midis mekanizmit referues të nivelit lokal dhe Komitetit Nacional për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Kjo do të përmirësojë në mënyrë të pashmangshme situatën aktuale në të cilën kuptimi i paqartë i rolit të komunës në lidhje me grumbullimin e informacionit mbi EDH shihet si problematik dhe mund të paraqesë një dobësi të konsiderueshme për zbatimin e përgjithshëm të Strategjisë Nacionale për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në nivel lokal.⁴⁰

Paraqitja vizuale e procesit të referimit



Burimi: Prezantimi i autorit

39 Filip Stojkovski, Ivan Stefanoski, Kristijan Aleksovski (2019), *Studimi bazë: Perceptimet e punonjësve të shkollave frontline dhe zyrtarëve të komunitetit nga Shkupi, Kumanova, Tetova dhe Gostivari mbi radikalizmin që çon në ekstremizëm të dhunshëm*, ed. Marija Risteska, CRPM

40 Ibid.

5. Financimi i modelit parandalues

Duke e marrë parasysh që institucionet në nivel qendror dhe lokal do të zbatojnë modelin parandalues për referimin e individëve që do të mbështeten në procesin e adresimit të dobësive ndaj radikalizimit, kjo do të kërkojë financim të përzier nga buxhetet qendrore dhe lokale.

Ashtu si në çështje të tjera, financimi i modelit duhet të konsiderohet nga niveli administrativ dhe programor. Në nivelin administrativ, struktura e modelit do të kërkojë që Komiteti Nacional për LKEDH dhe LKT të përfshijë ekspertizën dhe mbështetjen politike për modelin parandalues nën buxhetin e vet, ndërsa vetë komunat do të duhet të parashikojnë fonde për sistemin referues në nivel lokal. Në nivelin e programit, Komiteti Nacional për LKEDH dhe LKT do të duhet të financojë buxhetin për ngritjen e vetëdijes dhe aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve në nivel lokal dhe qendror, ndërsa komunat do të duhet të financojnë buxhetin e shërbimeve për të mbështetur individët të cilët janë të cenueshëm ndaj radikalizim. Duke e pasur parasysh se Komiteti Nacional nuk ka buxhet të vetin, ne rekomandojmë që qeveria të bëjë një buxhet të tillë në dispozicion, pasi pagesat nga Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë tentojnë të komplikojnë procedurat.

Megjithatë, me qëllim të përcaktimit të buxhetit të nevojshëm për krijesit e politikave ose institucioneve të pavarura të zhvillimit të politikave, nevojitet një vlerësim i kostos së modelit parandalues, në mënyrë që të ketë një llogari objektive se sa financim do të kërkojë modeli. Kostoja do të duhet të marrë parasysh përgjegjësitë, aktivitetet dhe rolet e reja që përmirësohen me zhvillimin e modelit parandalues. Rekomandohet që caktimi i kostos të kryhet në periudhën prill-tetor në mënyrë që kostot e parashikuara të përfshihen në ciklin e ri të buxhetit për vitin e ardhshëm. Kostoja mund të përcaktojë një plan financimi prej 5 vjetësh ku të gjithë mund të shpërndahen përgjatë periudhës kohore me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëria e ndërhyrjes.

Punëtoritë për zhvillimin e politikave të organizuara në kuadër të projektit E2P me qëllim të zhvillimit të modelit të propozuar kanë diskutuar mënyrat e financimit. Ndërsa në shumicën e komunave është e parapëlqyer dhe e pranuar përgjegjësia e përbashkët në financimin e modelit parandalues ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj lokale, në dy komuna,

Tetovë dhe Gostivar, ku u organizuan punëtoritë, disa rekomandime shitesë u rekomanduan. Pikërisht, duke marrë parasysh situatën aktuale në Gostivar me këshillin komunal, aktorët lokalë rekomanduan që një ndërhyrje e qeverisë qendrore do të ishte e nevojshme në mënyrë që buxheti i propozuar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm të miratohet nga këshilli komunal. Në Tetovë, miratimi i një buxheti për modelin parandalues nuk do të pengohet, por zbatimi i tij pritet të jetë problematik, pasi shumica e palëve të interesuara kanë probleme për të mbledhur pagesat nga komuna. Për këtë arsye rekomandohet llogari e veçantë ose fonde të dedikuara për funksionimin e modelit parandalues për të shmangur mundësinë që komuna të rialokojë fondet e parapara për modelin parandalues për qëllime të tjera.


6. Rritja e ndërgjegjësimit dhe trajnimi

